

REPUBLIKA E KOSOVIS- BEPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA Recencia Shtelehore per morojula e te onlanve personalo DRZAVNA AGENCIJA ZA ZAŠTITU LIČNIH PODATAKA MATIONAL ACENCY FOR PROTECTION OF PERSONAL PAIN ZYRA E ARKIVIT-KANCELARDIA ARNIYA- ARCHIVE OFF...



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Drzavna Agencija za Zastitu Licnih Podataka National Agency for Protection of Personal Data

> Nr. prot. /2012 Datë:10.10.2012

Në mbështetje të nenit 49 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.5.) të Ligjit Nr.03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 70/31 maj 2010) Mbikëqyrësi Shtetëror merr këtë:

## VENDIM

- Këshillohet Ministria e Drejtësisë që të marrë vendim për instalimin e sistemit të vëzhgimit me kamerë.
- Të vendosë njoftimin për instalimin e sistemit të vëzhgimit.
- Hapësira e ruajtjes së dosjeve të personelit të jetë më adekuate dhe e përshtatshme konform rëndësisë së dosjeve që duhet të ruhen në këtë sektor të rëndësishëm.
- Në regjistrin e hyrje daljes nga ndërtesa e Ministrisë të shtohet edhe kolona (hapësira) për shënimin e adresës së përhershme ose të përkohshme, si dhe arsyet e hyrjes në ndërtesë.
- Ministria e Drejtësisë, në afat prej 15 ditësh të njoftojë Agjencinë për zbatimin e këtij vendimi.
- 6. Vendimi hyn në fuqi ditën e pranimit të këtij vendimi.

## Arsyetim

Në bazë të nenit 46, nenit 47 dhe nenit 48 (paragrafi 1, 1.4.) të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në tekstin e mëtejmë LMDHP), më datë 19.09.2012, Agjencia ka realizuar kontrolle sipas detyrës zyrtare në Ministrinë e Drejtësisë.

Pas kontrollit është përpiluar procesverbali me nr.04/2012, i cili është nënshkruar nga zyrtari përgjegjës dhe të njëjtit i është dorëzuar një kopje.

Në bazë të kontrollit të bërë, në procesverbal është konstatuar kjo gjendje:

Ministria e Drejtësisë ka të instaluar sistemin e vëzhgimit me kamerë, por nuk ka vendim të shkruar për instalimin e sistemit të vëzhgimit. Në nenin 62 (paragrafi 1) thuhet personat në sektorin publik dhe privat mund të instalojnë sistemet e vëzhgimit me kamerë për vëzhgimin e ndërtesave të tyre, nëse konsiderohet e nevojshme për sigurinë e njerëzve dhe sigurimin e pasurisë. Vëzhgimi me kamerë, në veçanti, mund të jetë i nevojshëm për të vëzhguar hyrjet e ndërtesave ose ku për shkak të natyrës së punës së tyre ekziston kërcënim potencial ndaj të punësuarve.

Në nenin 62 (paragrafi 2 dhe 3) të LMDHP thuhet që vendimet e nevojshme merren nga nëpunësi kompetent, drejtori ose ndonjë person tjetër i autorizuar nga sektori publik ose privat. Vendimi duhet të përmbajë arsyet për vendosjen e sistemeve të vëzhgimit me kamerë.

MD nuk ka të vendosur njoftimin për instalimin e sistemet e vëzhgimit me kamerë. Në nenin 61 (paragrafi 2) të LMDHP thuhet se personat në sektorin publik ose privat që kanë për qëllim të instalojnë sistemet e vëzhgimit me kamerë duhet të vendosin njoftimin për këtë. Njoftimi i tillë duhet të jetë i dukshëm dhe të bëhet publik në mënyrë që t'i mundësojë subjekteve të të dhënave që pa vështirësi të njoftohen me masat, më së voni kur të fillojë vëzhgimi me kamerë.

Në nenin 64 (paragrafi 4) të LMDHP thuhet se para instalimit të sistemit të vëzhgimit me kamerë, punëdhënësi duhet t'i informojë me shkrim subjektet e të dhënave për të drejtat e tyre dhe arsyet për vëzhgim. Hapësirat e mbikëqyrura duhet të shënohen nga punëdhënësit përmes shenjave të përshtatshme.

Gjatë kontrollit kemi parë se dosjet e personelit ruhen në vend të sigurtë, por është konstatuar mundësia e qasjes nga persona tjerë të paautorizuar. Neni 14 i Ligjit Nr.03/L-172 parasheh që sigurimi i të dhënave personale përfshinë procedurat dhe masat e duhura organizative, teknike dhe logjiko-teknike për mbrojtjen e tyre dhe parandalimin e çfarëdo shkatërrimi të paqëllimshëm ose të qëllimshëm të paautorizuar, zbulimin, ndryshimin, qasjen ose përdorimin e të dhënave apo humbjen e papritur ose të qëllimshme të tyre, duke i mbrojtur lokalet, pajisjet dhe sistemet aplikative (softuerët), përfshirë edhe kontrollin e qasjes.

Në nenin 69 (paragrafi 2) i LMDHP parashiet që të dhënat e regjistrimit të personave që hyjnë ose dalin nga ndërtesat mund të përmbajnë vetëm këto të dhëna personale: emrin (at) personal, numrin dhe llojin e dokumentit të identifikimit, adresën e përhershme ose të përkohshme, datën dhe kohën si dhe arsyen për hyrje në ndërtesë.

Siç është përshkruar në arsyetimin e ketij vendimi, bazuar në nenin 49 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.5.) të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mbikëqyrësi shtetëror ka marrë vendimin e paraqitur në dispozitiv.

Adresa: Pejton Rr. Pashko Vasa Nr. 4, 10000 Prishtinë - Kosovë

## Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa, por mund të hapet konflikt administrativ në gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh.

## Ramadan Qehaja Mbikëqyrësi Shtetëror

Vendimi i dërgohet:

- Ministrisë së Drejtësisë
- Anëtarëve të Këshillit të Agjencisë
- Arkivit të Agjencisë

Adresa: Pejton Rr. Pashko Vasa Nr. 4, 10000 Prishtinë - Kosovë